



## FTESË

Në 21 Gusht 2019 ka hyrë në fuqi ligji “Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj vendos procedurat për ushtrimin e nismës ligjvënëse nga 20 000 zgjedhës dhe synon përfshirjen e tyre në proceset vendimmarrëse. Ai krijon mundësi për të gjithë shtetasit me të drejtë vote dhe për organizatat e shoqërisë civile, të propozojnë projektligje në Kuvend.

Në këtë kuadër, QNL ju fton të merrni pjesë në diskutimin me temë:

### **“Njohja dhe zbatimi i ligjit ‘Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve’ në kuadrin e konsolidimit të Shtetit të së Drejtës”**

Në mjediset e Universitetit “Luigj Gurakuqi”, Salla 501 tek Fakulteti i Drejtësisë, Shkodër

Dt. 21.11.2019, ora 10.00-12.30

Ky aktivitet organizohet në kuadrin e zbatimit të projektit “Rritja e pjesëmarrjes aktive të shtetasve përmes forcimit të nismës ligjvënëse të shtetasve dhe mjeteve të tjera kushtetuese”, zbatuar nga QNL me mbështetjen e Fondacionit “Shoqëria e hapur për Shqipërinë”.

Aktiviteti zhvillohet me bashkëpunimin e spikatur të Universitetit ‘Luigj Gurakuqi’ Shkodër.

Pjesëmarrja dhe diskutimet tuaja në këtë aktivitet janë shumë të rëndësishme.

Për më shumë detaje, ju lutem gjeni bashkëngjitur programin.

Lutemi konfirmoni pjesëmarrjen tuaj brenda datës 15.11.2019 në adresën [avokatore2@yahoo.com](mailto:avokatore2@yahoo.com)

Ju faleminderit!

**Av.Aurela Bozo**  
**Drejtore Ekzekutive**

**PROGRAMI**  
**TRYEZË DISKUTIMI**

**“Njohja dhe zbatimi i ligjit ‘Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve’ në kuadrin e konsolidimit të Shtetit të së Drejtës”**

21 Nëntor 2019

**10.00 -10.30** Regjistrimi i pjesëmarrësve dhe kafe e mëngjesit.

**10.30-10.40** Fjala e Mirëseardhjes dhe objektivat e Tryezës.

**Moderatore:** Av.Aurela Bozo

**10.40-11.10** Rëndësia e njohjes dhe e zbatimit të ligjit “*Për nismën ligjvënëse të zgjedhësve*”. Procedurat për konsultimin dhe paraqitjen e projektligjit me nismën e zgjedhësve përpara Kuvendit.

Prof.Asoc. Entela Hoxhaj , Universiteti “Luigj Gurakuqi”, Shkodër

**11.10-11.30** **Pyetje-përgjigje** për të njohur ligjin.

**11.30-12.20** **Diskutime** në lidhje me zbatimin e ligjit dhe sfidat në identifikimin dhe ndërmarrjen e nismave ligjvënëse qytetare.

**12.20-12.30** Konkluzione dhe rekomandime të Tryezës

**Mbyllja e Aktivitetit**